



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA SUPREME – VRHOVNI SUD

GJS-2023-008

Ushtruesja e Detyrës së Kryetarit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Mejreme Memaj, bazuar në nenin 9 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 dhe paragrafi 6 i Ligjit nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga avokat Ali Latifi, me autorizim nga Këshilli Grevist “IMF” të Punëtorëve të Fabrikës së Tubave në Ferizaj, për inicim të procedurës disiplinore ndaj Kryetarit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, M.T., dhe gjyqtarit të kësaj gjykate F.A, më 29.05.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paraqitur nga e avokatit Ali Latifi, përfaqësues i autorizuar i palëve Këshilli Grevist “IMF” të Punëtorëve të Fabrikës së Tubave në Ferizaj, ndaj Kryetarit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, M.T., dhe gjyqtarit të së njëjtës gjykatë F. A.

A r s y e t i m

Përfaqësuesi me autorizim i palëve, avokat Ali Latifi, më 26 prill 2023, ka paraqitur ankesë ndaj Kryetarit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, M.T., dhe gjyqtarit të së njëjtës gjykatë –F. A., të cilën ankesë ia ka drejtuar autoritetit jo kompetentë kryesuesit të Këshillit Gjyqësor.

Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës më 16 maj 2023, konform nenit 9 par.2 të Ligjit për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokuroreve e ka përcjellë ankesën tek Gjykata Supreme si autoritet kompetent sa i përket pretendimeve të shkeljeve disiplinore të Kryetareve të Gjykatave Themelore dhe Kryetarit të Gjykatës së Apelit (neni 9 par.1 nënpar.1.2 i ligjit të lartcekur).

Parashtruesi i ankesës pretendon se kryetari Gjykatës Themelore në Ferizaj, dhe gjyqtari i së njëjtës gjykatë F.A., kanë bërë shkelje disiplinore ngase të njëjtit përmes personave të

paautorizuar, kanë mbajtur takime të fshehta dhe kanë lejuar ekzekutimin e aktgjykimit i cili është i plotfuqishëm nga viti 2005, në vlerë prej 25.649.250 €, për 192 punëtorë. Gjykata ka marrë iniciativë nga të paautorizuarit e jashtëligjshëm, duke i anashkaluar kërkesat e punëtorëve nga vit 2001, ku kanë bërë shkelje të rënda procedurale dhe ligjore, duke abuzuar detyrën nga gjyqtari i rastit dhe tani kryetari i Gjykatës M.T, i cili e mbron gjyqtarin F.A., i cili ka mbajtur konsultime - seanca dëgjimore, me datë 27.05.2019, me S.D., me personin jo legjitim, duke injoruar avokatin e autorizuar dhe Këshillin Grevist, N.A., etj. Si dëshmi ankesës ia ka bashkangjitur aktvendimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj, ADGJTHFR.nr.3/23, të datës 230.03.2023, me të cilin është refuzuar kërkesa e këshillit legjitim grevist si e pabazuar. Këshilli grevist, me datë 18.04.2023, i është përgjigje në ankesë Kryetarit më këto fakte, por nuk kanë marrë përgjigje dhe nuk i ka pranuar; Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Ferizaj, C.nr.340/2001; aktvendimin për ekzekutim të Gjykatës Komunale E. 469/2005 të datës 24.03.2006; aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese rasti KI-08/09 nr. ref AGL 75/10 i datës 17 dhjetor 2010; Vendimin e qeverisë së Republikës së Kosovës nr.08/186 29 prill 2014; Vendimin e Kuvendit të R. Kosovës nr.04-V-799 19 mars 2014; udhëzimin e odës së veçantë të Gjykatës Supreme të R. Kosovës C-IV-14-4332 të datës 13 qershor 2014; Ekspetizën ligjore të për llogaritjes së pagave për 912 punëtorët (kreditorët) për secilin veç e veç për periudhën kohore sa ishin të larguar padrejtësisht në kundërshtim me ligjin në fuqi nga vendet e tyre të punës; komplet dokumentacionin valid personal për implementim të ekzekutimit për secilin kreditor veç e veç, dhe autorizimet valide që janë në fuqi dhe të pa revokueshme. Kërkon që të verifikohen këto dëshmi për shërimin e kancerit që po vepron në emër të drejtësisë, duke u bazuar në shkresa të lëndës dhe kërkesave të drejta të Këshillit të Grevistëve të SHS(shoqatës sindikale)- “IMF - Fabrikës së Tubave të Çelikut Ferizaj”.

Edhe pse ankesa nuk përmban elementet e përcaktuara sipas nenit 9 par.4 të Ligjit për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, si autoritet kompetent me qëllim të vërtetimit bazës së arsyeshme siç kërkohet me ligj, të këtyre pretendimeve në drejtim të shkeljeve të supozuara nga Kryetari i Gjykatës dhe gjyqtarit të çështjes kamë kërkuar nga të njëjtit që të deklarohen dhe kamë pranuar deklaratat e tyre.

Kryetari i Gjykatës, në deklaratën e tij thekson se pretendimet e ankuesit janë jo serioze dhe plotësisht të pa bazuara. Si kryetar jo vetëm në këtë rast, por asnjëherë nuk ka mbajtur takime të fshehta me askënd, dhe ky pretendim jo që nuk është i vërtet, por është edhe shqetësues, se si një avokat, që është profesionist në fushë të paraqesë kësi pretendime të pabazuara dhe të pa argumentuara për një person, e në rastin konkret për mua si kryetar i gjykatës. Kurse, edhe pretendimi se kam lejuar ekzekutimin e aktgjykimit të vitit 2005 është po ashtu i pabazuar, pasi që për lejimin e ekzekutimeve të aktgjykimeve vendos gjyqtari përmbarues dhe jo kryetari i gjykatës. Lidhur me këtë çështje pas kërkesave me shkrim të këshillit grevist, si kryetar së bashku me administratorin e gjykatës, ka pritur në takim përfaqësues të këtij këshilli N.A. dhe A.S. (të cilët i përfaqëson ankuesi avokati Ali Latifi), të cilët kanë kërkuar nga unë si kryetar të pajisen me shkresa të lëndës, që të takohen me gjyqtarin, kanë shprehë brengën e tyre për mos trajtimin si persona kompetent në procedurë nga ana e gjyqtarit dhe se gjyqtari të caktoj seancë dëgjimore apo të kenë takim me gjyqtarin. I ka njoftuar se të gjitha kërkesat që i kanë lidhur me këtë çështje të bëhen përmes parashtrësve. Po ashtu i ka njoftuar se si kryetar i

gjykatës, në bazë të ligjit dhe rregulloreve ka autoritet të kujdeset për të siguruar që administrimi i gjykatës të kryhet në mënyrë korrekte, efektive, efikase dhe të ligjshme, por jo edhe të vendosi për çështjet që janë në procedurë dhe as të jap komente për mënyrën e vendosjes nga ana e gjyqtarit, sepse gjyqtarët në punën e tyre janë të pavarur të vendosin sipas provave dhe fakteve të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe sipas ligjeve në fuqi, dhe se nuk ka autoritet t'i vlerësoj vendimet e gjyqtarëve, për shkelje të dispozitave të procedurës ligjore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike apo zbatimit të gabuar të së drejtës materiale nga ana e gjyqtarëve, pasi që këto janë çështje që mund të goditen përmes ushtrimit të mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike në gjykatat me të larta nga palët e pakënaqura, të cilat e kanë të drejtën e vlerësimit të ligjshmërisë së një vendimi gjyqësor. Shton se në Gjykatën Themelore në Ferizaj, është duke u zhvilluar procedura përmbartimore e evidentuar E.nr.469/05, ku si kreditor janë punëtorët e “IMK” - Fabrika për Prodhimin e Gypave të Çelikut në Ferizaj, kundër debitorëve “IMK” - Fabrika për Prodhimin e Gypave të Çelikut në Ferizaj, të cilët përfaqësohen nga AKP dhe debitorëve Qeveria e Kosovës. Gjyqtari i çështjes F.A., me datë 27.05.2019, ka mbajtur seancë dëgjimore lidhur me këtë çështje me palët që gjyqtari i ka ftuar. Me aktvendimin E.nr.469/05 datë 10.10.2022 ka pranuar në tërësi propozimin e përfaqësuesve të kreditorëve të përfaqësuar nga avokati Sokol Dobruna dhe është caktuar përmbartimi edhe ndaj debitorit Qeveria e Kosovës. Po ashtu me aktvendimin E.nr.496/05 të datës 30.12.2022, ka refuzuar prapësimin e përfaqësuesit të debitorit Qeveria e Kosovës, ndërsa ka hedhur poshtë si të palejueshëm prapësimin e debitorit NSH “IMK”, dhe tani kjo lëndë sipas gjyqtarit të çështjes gjendet në Gjykatën e Apelit të Kosovës, për të vendosur lidhur me ankesat e debitorit “IMK” —Ferizaj — AKP dhe Qeveria e Republikës së Kosovës. Pas të gjithë kësaj, avokati Ali Latifi, në Këshillin Gjyqësor të Kosovës ka paraqitur ankesë ndaj gjyqtarit F.A., duke shprehur shqetësimet e tija lidhur me aktvendimin E.nr.496/05 (sipas Aktgjykimit C.nr.340/01), i cili ka pretenduar se gjyqtari ka abuzuar qëllimshëm dhe ka mbajtur komunikime ex-parte me palët për rastin konkret. KGJK, konform nenit 9 par. I të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, këtë ankesë e ka transferuar tek Kryetari i Gjykatës si Autoritet Kompetent për trajtimin e ankesave të palëve ndaj gjyqtarëve. Si autoritet kompetent, në rastin konkret ka ndërmarrë të gjitha veprimet konform ligjit dhe rregullores, ka marrë edhe deklaratë nga gjyqtari i çështjes F.A., dhe pas analizimit të gjitha këtyre, konform nenit 9 paragrafi 6 i ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve si dhe nenit 6, 7 par.3 të rregullores nr.05/19 për Procedurën disiplinore të gjyqtarëve, me Vendimin ADGJTHFR.nr.3/23, të datë 23 mars 2023, ka refuzuar si të pabazuar kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit F.A.. Me datë 18.04.2023, në gjykatë është pranuar ankesa nga Këshilli Grevist IMF Fabrika e Tubave të Çeliktë Ferizaj, ndaj vendimit të Autoritetit Kompetent ADGJTHFR.nr.3/23 të datë 23 mars 2023. Si Autoritet Kompetent me aktin përcjellës të datës 18.04.2023, ka njoftuar Këshillin Gjyqësor të Kosovës, se Gjykata Themelore në Ferizaj ka pranuar ankesën e lartcekur me të cilën është refuzuar si e pabazuar kërkesa për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit F.A., dhe përkundër faktit se ligji nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, por edhe sipas rregullores 05/19 për Procedurën Disiplinore ndaj gjyqtarëve, nuk parashihet që kundër vendimit të autoritetit kompetent mund të ushtrohet ankesë, megjithatë ankesën e parashtruar nga pala ua kam përcjell KGJK-së, për ta shqyrtuar. Dhe sigurisht pala do të njoftohet nga KGJK-ja lidhur me këtë ankesë të tij.

Gjyqtari F.A., në deklaratën e tij thekson se lënda E.nr.469/05, me datë 10.02.2023, është pranuar në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë së bashku me të gjitha shkresat e saj, për vendosjen sipas ankesave të debitorëve, dhe në mungesë të shkresave të lëndës gjykata në këtë deklaratë nuk mund të përdorë numra apo data të sakta sa i përket autorizimeve nga palët të cilët gjinden në shkresat e lëndës. Gjykata me 27.05.2019, në kuadër të veprimeve përmbarimore në lëndën E.nr.469/05, të kreditorëve A.L., etj, kundër debitorit “IMK”-Ferizaj, e përfaqësuar nga AKP-ja zyra regjionale në Gjilan, ka mbajtur seancën dëgjimore publike, në të cilën kanë prezantuar i autorizuari i përfaqësuesit të kreditorëve, përfaqësuesit të Sindikatës së IMK-së Ferizaj, si dhe përfaqësuesi nga AKP-ja – zyra regjionale në Gjilan.

I autorizuari i përfaqësuesit të sindikatës së IMK-së, avokati Sokol Dobruna në këtë gjykatë e ka bërë zgjerimin e propozimit për përmbarim në kuptimin subjektiv, duke i propozuar gjykatës që të caktohet përmbarimi edhe ndaj debitorit të dytë, Qeveria e Republikës së Kosovës, në bazë të aktgjykimit të lëshuar nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës e numër REF.nr.AGJ 75/10, me numër të rastit KI.nr.08/09, të datës 17.12.2010.Gjykata duke vendosur lidhur me propozimin e të autorizuarit të përfaqësuesit të sindikatës së IMK-së, me aktvendimin e datës 10.10.2022, e ka pranuar në tërësi propozimin e përmendur më lartë dhe e ka caktuar përmbarimin edhe ndaj debitorit Qeveria e Republikës së Kosovës, në bazë të aktgjykimit REF.nr.AGJ 75/10, me numër të rastit KI.nr. 08/09, të datës 17.12.2010, të lëshuar nga Gjykata Kushtetues e Kosovës. Kundër aktvendimit të datës 10.10.2022, debitorët kanë ushtruar prapësim, brenda afatit ligjor, kurse gjykata me aktvendimin e datës 30.12.2022, e ka refuzuar në tërësi si të pa bazuar prapësimin e debitorit Qeveria e Republikës së Kosovës, gjegjësisht e ka hedhë si të palejueshëm prapësimin e përfaqësuesit të debitorit NSH “IMK” - Ferizaj, AKP zyra regjionale në Gjilan, ndërsa ka vendosur të mbetet në fuqi aktvendimi E.nr.469/05, i datës 10.10.2022. Sa i përket pretendimeve të avokatit se ai dhe kryetari i gjykatës kanë mbajtur takime të fshehta dhe kanë lejuar ekzekutimin e aktgjykimit të plotfuqishëm nga viti 2005, konsideron se janë të pabazuara dhe të pa mbështetur në prova, sepse gjykata në punën e saj është tërësisht transparente dhe thujtë të gjitha seancat dëgjimore i mban të hapura me përjashtim të atyre për të cilat ligji parashikon të mbahen pa publik dhe në rastin konkret gjykata ka mbajtur seancën dëgjimore publike me datë 27.09.2019, në të cilën kanë marr pjesë i autorizuari avokati Sokol Dobruna dhe përfaqësuesi i debitorit IMK-Ferizaj, nga AKP Zyra regjionale në Gjilan dhe fakti se gjykata ka mbajtur seancën dëgjimore dhe pas seancës dëgjimore të cekur më lart e ka caktuar përmbarimin e propozuar edhe ndaj debitorit Qeveria e Republikës së Kosovës, të cilat veprime i ka ndërmarr në bazë të autorizimeve gjegjëse të lëshuara nga noteri kompetent (autorizimi gjendet në shkresat e lëndës), nuk nënkupton aspak komunikim ex-parte me palët dhe nuk nënkupton aspak komunikim të fshehtë siç pretendon ankuesi, për arsye se komunikimi ex- parte nënkupton diçka tjetër nga ajo që pretendon ankuese. Për më tepër, Gjykata në pajtim me dispozitat e nenit 107, par 1, të LPK-së, i ka dorëzuar shkresat, vendimet e ndërmarra nga gjykata palëve dhe të autorizuarve të tyre. Në fund ri thekson se të gjitha veprimet procedurale të ndërmarra në lëndën E.nr.469/05, janë veprime që janë ndërmarr brenda fushëveprimit të detyrave dhe përgjegjësi si gjyqtar, së pari në pajtim të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, nenit 107, paragrafi 1, të Ligjit Nr.03/L-006, për Procedurën Kontestimore, të Ligjit për Procedurën Përmbarimore dhe Ligjit për Gjykatat në Republikën e Kosovës, si dhe me të gjitha ligjet tjera në fuqi.

Pas analizimit të pretendimeve të ofruara nga parashtruesi i ankesës, deklaratës së kryetarit dhe gjyqtarit dhe provave të cilat ia kanë bashkëngjitur deklaratave, vlerësojë se në rastin konkret nuk ka vend për të hapur rast disiplinor ndaj tyre për këto arsye:

Së pari, me ankesë nuk kemi një përshkrim konciz të aspekteve faktike dhe juridike mbi të cilat është ngritur ankesa për shkelje disiplinore të kryera qoftë nga kryetari i gjykatës qoftë nga gjyqtari i çështjes.

Se dyti, ankesa është dukshëm jo serioze, sepse ankuesi është avokat dhe pretendon se kryetari dhe gjyqtari kanë abuzuar me detyrën, por këto pretendime me asgjë nuk i argumenton, në fakt ai ju referohet shkresave me të cilat i është drejtuar gjykatës. Kurse, në fakt e terë përmbajtja e ankesës ka të bëjë me procesin e vendimmarrjes së gjyqtarit të çështjes në procedurën përmbare, të cilat vendime as kryetari i gjykatës nuk mund t'i vlerësoj dhe komentoj sepse gjyqtarët janë të pavarur në ushtrimin e funksionit të tyre respektivisht në punën e tyre, dhe siç del nga provat e bashkangjitura rasti të cilit i referohet ankuesi është në gjykatën e shkallës së dytë me ankesë. Në këtë drejtim as unë si autoritet kompetent nuk kam kompetencë të vlerësoj mënyrën e vendosjes dhe vendimet e marra nga gjyqtari i çështjes.

Nga arsyet e cekura e në bazë të nenit 9 par. 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, dhe nenit 7 par.3 nënpar. 3.2 të Rregullores së KGJK-së, nr.05/2019, për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

Mejreme Memaj
U.D. Kryetare e Gjykatës Supreme

Kopje:

1. Këshilli Gjyqësor i Kosovës,
2. Kryetarit të Gjykatës Themelore në Ferizaj,
3. Gjyqtarit të Gjykatës Themelore në Ferizaj,
4. Palës ankuese,
5. Arkivit të Gjykatës Supreme.